

SERIOZITETI

HYRJE

Po vazhdojmë me ligjin e Allahut në bazë të cilit ndryshon gjendjen pozitivisht.

“Vërtet Allahu nuk e ndryshon (pozitivisht) gjendjen e një populli, derisa ata ta ndryshojnë gjendjen e tyre.”

(Erraëd, 11)

Virus shkatërrues, i cili virus deri më sot as që ka ekzistuar në mesin e muslimanëve, të cilin virus e konsiderojmë të parëndësishëm. Ai virus është ‘joserioziteti’.

Ne dëshirojmë që të arrijmë te parimi i Zotit të Lartmadhëruar, i cili ka vendosur parim të përmirësimit dhe ndryshimin pozitivisht kur ka thënë: **“Vërtet Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata ta ndryshojnë gjendjen e tyre.”** *(Erraëd, 11)*, të cilin e kemi përmendur edhe më herët.

Angazhohemi në shërimin e plagëve. Angazhohemi që joserioziteti, neglizhenca të shndërrohen në aktivitet, punë, sinqeritet, përpikëri dhe seriozitet.

Unë po turpërohem edhe me i përmend këto të meta, këto mangësi dhe këto dukuri negative, për këtë arsye kërkoj falje nga ju pse po i përmendi, mirëpo domosdoshmëri e thirrjes islame është për të tërhequr vërejtjen në këto sëmundje, të meta dhe dukuri negative, sepse janë përhapur në rinin e umetit, e cila përfaqëson përafërsisht 70% të shoqërisë, ndërsa rinia e perëndimit e përfaqëson 20% ose 30% të shoqërisë së tyre. Kjo do të thotë se ardhmëria e këtij shekulli është ardhmëri e umetit tonë, pasi që ka rini më shumë se tjerët.

Për këtë arsye është domosdoshmëri që të angazhohemi për t’i shëruar dukuritë negative në rini, dhe për të përmirësuar gjendjen e tyre.

Vegjelia ka shëndet, jo mendje, ndërsa pleqëria ka urtësi, e jo fuqi, ndërsa rinia i posedon që të dyja, edhe shëndetin edhe urtësinë. Për këtë arsye umeti (shoqëria) nuk matet me petrol, naftë e industri, por matet me rininë e tij dhe përkujdesjen, dhe zhvillimin e tyre.

Dijetarët e kanë e përcaktuar afatin, epokën e çdo shoqërie, duke përcaktuar e krahasuar me një shoqëri tjetër, duke e analizuar seriozitetin e asaj shoqërie, me fjalë të tjera, seriozitetin e rinisë së asaj shoqërie dhe rolin e tyre në shoqëri.

Për këtë arsye angazhohemi në shërimin e brengave të rinisë dhe zhvillim e tyre.

Angazhimi im është që ata t’i marrin detyrat me përgjegjësi, që të jenë faktorë kryesorë në realizimin e çështjes së fesë së tyre.

Lus Allahun që gjithsecili që e lexon këtë punim dhe këtë mesazh timin, të sjell dobi dhe ta bëjë rrugë, e cila shpie në seriozitet, vendosmëri dhe ta marrin përgjegjësinë mbi supe djelmoshat e këtij umeti.

Të jetë nxitje, shtytje dhe angazhim në përmirësimin e gjendjes së mjerë momentale, sepse Allahu i Lartë e i Madhëruar ka mundësi që ta bëjë këtë, ndërsa neve na mjafton vetëm Allahu, dhe nuk ka mbrojtës, dhe ndihmëtar më të mirë se Ai.

DISA LLOJE TË JOSERIOZITETIT

Në mesin tonë, në shumë çështje na mungon serioziteti. Unë nuk dua t'i demoralizoj të rinjtë, se e di se në mesin e të rinjve tanë është rizgjimi dhe revolucioni, mirëpo duhet të ndalemi në mëkatet tona, të metat tona, dhe mos t'i injorojmë ato, derisa të jemi në gjendje t'i shërojmë dhe t'i ndryshojmë pozitivisht, dhe ta ngritnim flamurin tonë mbi të gjithë popujt.

Ka shumë forma të joseriozitetit, po i përmendim disa prej tyre:

- Falsifikimi në provime

Si është e mundur që umeti të fitoj dhe ngrit flamurin mbi të gjithë popujt, kur studentët nuk janë serioz dhe nuk iu japin rëndësi studimit, por mbështeten në mashtrime.

Si është e mundur që umeti të fitoj dhe të ngrit flamurin mbi të gjithë popujt kur arsimtarët, profesorët, edukatorët i kalojnë studentët pa mësuar fare, kjo tregon se ato bëjnë vetëvrasje të popullit, iu ndihmojnë nxënësve dhe studentëve për tradhti, ndërsa thonë se këtë e bëjnë pse janë të mëshirshëm dhe për këtë arsye i ndihmojnë studentëve, ndërsa nuk e dinë se me këtë prodhojnë gjeneratë joserioze dhe dështuese.

Si është e mundur që umeti të fitojë dhe të ngritë flamurin mbi të gjithë popujt kur personat më eminent dhe më të përgjegjshëm u ndihmojnë tjerëve për të mashtruar, bile edhe ju sqarojnë mënyrat si të mashtrojnë dhe si të tradhtojnë.

Si është e mundur që umeti të fitoj dhe të ngrit flamurin mbi të gjithë popujt në këso mënyra.

Një njeri më ka dërguar një letër ku shkruante:

“A mendon se “Duatë” (Thirrësit në Islam) mund ta çlirojnë umetin pa zhvillim dhe pa përparim?!”

Pa marr parasysh se në letër i ka nënvlerësua Duatë (Thirrësit në Islam), për të cilën as nuk e pëlqejmë e as nuk pajtohem, ai ka të drejtë në një pikë e ajo është se Duatë (Thirrësit në Islam) duhet të punojnë dhe të angazhohen, sikurse në punë nevojitet mund dhe lutje, pse Zoti i Lartmadhëruar nuk e ndryshon gjendjen e një populli pozitivisht, pa e ndryshuar veten, si në aspektin edukativ, të adhurimit dhe të veprimit.

Unë them: Kriza e Irakut do të përsëritet (do të zgjerohet), nëse nuk e ndryshojmë gjendjen tonë. U them qeveritarëve dhe profesorëve:

A është e logjikshme t'i ndihmuar studentëve se si duhet për të mashtruar?!

Si mundën me qenë studentët e gëzuar me kalimin e provimit me mashtrim?!

Përsëritja e provimit të studentit është më e vlefshme se sa për ta ndërtuar jetën e tij mbi bazat e iluzioneve dhe të mashtrimeve.

A është e logjikshme që muslimanët vriten në Palestinë, Çeçeni, Irak, ndërsa vazhdojnë tregimet për dashuri në mes të djelmoshave dhe vajzave?!

Vëllezër!

Ju lutem, bëhuni pozitiv, shkoni te ata të cilët mendojnë negativisht dhe me butësi ktheni në anën e pozitivitetit dhe le t'i përmbahen ligjeve të Allahut, le të largohen prej mëkateve.

Zoti i Madhëruar thotë:

“Thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi e mençuri dhe me këshilla të mira.”

En-Nahl 125

Joseriozët zgjoni nga gjumi!

Po më tregon një djalosh se derisa shkonte rrugës kur e dëgjon një të ri, i cili llafosej me prindin e vet në telefon, pse ia ka blerë vëllait të tij një automjet të shtrenjtë, ai dëshironte edhe atij që t'ia blejë një të tillë si të vëllait të tij.

Ky djalosh më tregonte se ka qarë për atë se si djali me babën llafosej për shkak veture.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH.

Vëllezër!

Bota është kalimtare, ndërsa aq shumë angazhohemi dhe luftojmë për të sikur të ishte e përgjithmonshme.

Bijat e muslimanëve janë zhytur në këtë botë dhe nuk kanë në çka të angazhohen, pos me kozmetikë, stolisje dhe gardërobë. Ato nuk merren me diç tjetër pos dashurisë dhe çështjeve të ndaluara.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH.

Vajzave nuk u intereson diç tjetër, pos gardërobës, veshmbathjet e ngushta, derisa ta arrij djalin, i cili iu pëlqen.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH.

Vajzave nuk u intereson diç tjetër, pos modeleve më të reja për ta përvetësuar djalin e dëshiruar.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH.

Vajzave nuk u intereson diç tjetër, pos modës e cila ua tregon formën e trupit të tyre derisa ta përvetësojnë djalin e dëshiruar.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH.

Vajzës nuk i intereson fitimi i xhenetit, apo shpëtimi prej zjarrit të xhehenemit, asaj i intereson stolisja në këtë botë dhe veprimet haramë.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH.

Bijtë tanë shkojnë në bodybuilding jo për ta e strukturuar trupin për t'i ndihmuar islamit, por për t'i tërheq vajzat me trupin e tyre.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH.

Bijtë tanë shkojnë te rrojtoria deri me orë të tëra për t'i rregulluar flokët për t'i përvetësuar vajzat.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH.

Vëllezër!

A e kuptoni se ka programe speciale satelitore te cilat shërbejnë për lidhjen në mes djemve dhe vajzave.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH.

Vajza i thotë djalit të panjohur (nëpërmjet satelitit): Të dua, ndërsa djali i thotë vajzës së panjohur (nëpërmjet satelitit): Të dua.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH.

Ka kanale satelitore të cilët bashkëpunojnë me shejtanët për ta shkatërrua islamin duke korresponduar me bijat tona me fjalë dashurie.

Ka edhe çështje tjera edhe më të shëmtuara.

Vëllezër!!

Në çfarë pozite jemi, ndërsa në anën tjetër muslimanët vriten, torturohen, vdesin e dëbohen?!

A është e logjikshme që prej perëndimit të pranohet ajo çka është më e keqja te ato, e për ta refuzuar ajo çka është më e mira te ato?!

E pranojmë prej tyre krimin, humbjen e moralit, e nuk e marrim prej tyre seriozitetin në punë, precizitetin dhe përpikërinë.

Si mundet umeti të zhvillohet, të përparojë dhe të ngritet, e të shërohet nga dobësia, ndërsa jeton në gjumë të thellë?!

3. Kush vallëzon natën e dasmës

Çka janë këto ahengje dhe dëfrime, derisa vëllezërit në Palestinë dhe Irak e dimë se në çfarë gjendje janë?!

4. Në aheng këngëtari këndon, ndërsa djemtë e vajzat vallëzojnë

Si është e mundur që kjo të ndodh në vendin islam. Nuk mundet që umeti të përparojë dhe të ngrihet e ta kthejë krenarin dhe vendin e merituar kur të gjitha interesimet i ka në këngë, filma dhe seriale.

Omer bin Hatabi r.a. e ka parë një djalosh duke ecur në rrugë dhe shkonte i lëkundur, dhe pasiv. Omeri r.a. e ndalë dhe i thotë: A mos jeni i sëmurë? – Djaloshi i thotë: Jo, o Emir i besimtarëve. Omeri r.a., Emir i besimtarëve i mëshon dhe i thotë: Ajo çka dëshirojmë është që asnjë prej umetit të Muhamedit a.s. të mos ecë kështu.

A mund ta kuptoni këtë?

Omeri r.a. ka dëshiruar seriozitet, gjallëri, fuqi, e jo dobësi e përtaci.

5. Vajza turpërohet që t'i tregojë shoqes së saj se ajo i ndihmon nënës në punët e shtëpisë.

Si është e mundur të turpërohet prej shoqes së saj e nuk turpërohet prej Allahut, i Cili ka urdhëruar për mirësi dhe forcim të raporteve.

Po, kjo është e pranishme në vendet islame.

Po, vajzat interesohen vetëm për modelet më të reja të veshjes, për gardërobën dhe modën.

Po, vajzat interesohen vetëm për atë që sa më tërheqëse me qenë para meshkujve.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH.

6. Adoleshentët shëtisin me vetura pandërprerë për të hulumtuar vajza e për t'u dëfryer me to.

7. Adoleshentët djem dhe vajza tërë natën e kalojnë duke folur në telefon, duke ngacmuar njëri-tjetrin dhe duke biseduar me njëri-tjetrin.

8. Neglizhenca për me t'iu ndihmuar muslimanëve në Palestinë, Irak dhe vende tjera islame.

Shumica e të rinjve dhe muslimanëve janë larguar nga detyrat e tyre e angazhohen në çështje të kota, të padobishme dhe që nuk kanë vlerë.

Pak prej tyre brengosen dhe interesohen për çështjen e palestinezëve, Irakut dhe vendeve tjera islame.

Mirëpo kjo është vetëm emocionalisht e asgjë më shumë.

Nevojitet seriozitet në adhurim, dhe largim nga mëkatet.

Nevojitet serioziteti, sinqeriteti në lutje, në përkushtim ndaj Allahut, për t'iu ndihmuar Allahu atyre, për t'i përkrahur për të dalur fitimtarë.

Nevojitet seriozitet në bllokadën ekonomike ndaj armiqve të tyre.

Nevojitet serioziteti në përkrahje morale e financiare dhe ndihma në të gjitha llojet legjitime.

Nevojitet mos me qenë si beni israilët dhe mos me iu përngjarë atyre në mos interesim dhe joseriozitet.

Kur iu ka thënë Musa a.s. :

“O populli im, hyni në tokën e shenjtë, të cilën e ka caktuar Allahu, e mos ikni, duke ia kthyer shpinën, se do të jeni të humbur.”

Maide 21

“O Musa, në atë vend është një popull kriminel, e ne nuk do të hymë në të, pa dalë ata nga aty. Nëqoftëse ata dalin prej aty, ne vetëm atëherë do të hymë.”

Maide 22

“O Musa, padyshim, ne kurrë nuk do të hymë derisa ata janë aty. Dhe shko ti me Zotin tënd luftoni, e ne do të qëndrojmë ulur këtu.”

Maide 24

Çfarë ishte rezultati?

Allahu i Lartmadhëruar thotë:

“Ai vend është i ndaluar për ta, 40 vite do të enden nëpër toka, e ti mos u dëshpëro për popullin mëkatarë.”

Maide 26

Do të thotë, ia ka ndaluar atyre për të hyrë në tokën e shenjtë katërdhjetë vite, e gjatë atyre katërdhjetë viteve të bredhin nëpër tokë.

Mirëpo pyetja është: Pse ndalimi me qenë 40 vite? Sepse kjo periudhë kohore është e mjaftueshme me ndryshua një gjeneratë joserioze dhe e pa interesuar për çështjet e tyre.

Vëllezër!

Për së dyti kërkoj falje se po marr kësi shembulli jo të mirë, i cili tregon për joseriozitetin dhe ajo çka është e prezente në umetin tonë: Mirëpo, po ndodh e gjithë kjo. Në Irak, në Palestinë, në Çeçeni: vriten, torturohen, e dëbohen muslimanët nga vendet e tyre.

Si mundet të zgjohet dhe të ngritet umeti kur me gjitha këto ndodhi, ngjarje e shkatërrime ndërsa askush nuk mërzhitet për çështjen e islamit dhe të muslimanëve?!

Është e domosdoshme ta ndryshojmë gjendjen tonë në atë çka është në kënaqësinë e Allahut, me qëllim që ta ndryshojë gjendjen tonë pozitivisht, që të arrijmë forcën dhe krenarinë edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër.

Është e domosdoshme ta ndryshojmë vetveten, sepse Allahu i Lartmadhëruar thotë:

“Vërtet Allahu nuk e ndryshon (pozitivisht) gjendjen e një populli, derisa ata ta ndryshojnë gjendjen e tyre.”

Erraëd 11

Vëllezër!

Joseriozitetin në mesin e islamit dhe muslimanëve duhet ta zëvendësojmë me seriozitet, përpikëri, me qëllim që islami të ngrihet, të zhvillohet dhe të përparoj.

Ngatërresat, shkatërrimet duhet t'i zëvendësojmë me udhëzim dhe këshilla.

Pasimin e kriminelëve duhet ta zëvendësojmë me mbështetje dhe pasim ndaj të mirëve.

Jopërgjegjësinë duhet ta zëvendësojmë me përgjegjësi.

Duhet të ndryshojmë, të ndryshojmë, të ndryshojmë...

“Vërtet Allahu nuk e ndryshon (pozitivisht) gjendjen e një populli, derisa ata ta ndryshojnë gjendjen e tyre.”

Erraëd 11

Përkundër gjithë asaj çka përmendëm, ende ekzistojnë shpresat, Islami ka perspektivë dhe ardhmëria është e islamit, përpjekjet dhe evoluimi dita-ditës shtohen.

Edhe pse e keqja ekziston, kjo nuk do të thotë se e mira, të mirët dhe këshilluesit për të mirë janë zhdukur njëherë e përgjithmonë.

Të gjithë të rinjtë nuk janë negativ dhe kriminel, por zgjimi dhe kthimi te Allahu Falës veç është në lulëzim e sipër..

SERIOZITETI NË PLANPROGRAMIN BAZË TË ISLAMIT

Allahu i Lartmadhëruar thotë:

“Atë çka u kemi dhënë, merreni me seriozitet dhe forcë.”

El Bekare 63

“Merre atë me forcë dhe urdhëroje popullin tënd që ta marrin atë çka është më e mira.”

El Earaf 145

“Më ndihmoni dhe më përkrahni me forcë.”

El Kehf 95

“O Jahja, merre librin me forcë. Ne i kemi dhënë atij forcë dhe urtësi që nga fëmijëria.”

Merjem 12

Ne e shohim se fjala “me forcë” vazhdimisht përsëritet në librin e Allahut, që do të thotë Allahu ka tregua vlerën dhe rëndësinë e seriozitetit dhe përgjegjësisë.

Allahu i Lartmadhëruar ka thënë: “O besimtarë, kur të konfrontoheni me ndonjë armatë (të armikut) përqendrohuni, bëhuni të fortë dhe kujtojeni Allahun pandërprerë.”

El-Enfal 45

Ky ajet fisnik na tregon për dy çështje të rëndësishme kur të jetë krizë, rrezik dhe konfrontimi me armikun:

1. Përforcimi, që do të thotë ‘serioziteti’
2. Përkujtimi i Allahut të Lartmadhëruar, i cili është ibadeti më i vlefshmi dhe rrugë kryesore për qetësimin e zemrës dhe të shpirtit.

Serioziteti ka qenë cilësi e peygamberëve dhe të dërguarve.

Ibrahimi a.s. ka qenë djalosh i ri kur i ka thye idhujt dhe është ballafaquar me pabesimtarët, mirëpo ka qenë i vendosur, serioz dhe çështjen e thirrjes në islam e ka marrë me përgjegjësi.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“(A të kujtohet) Kur ai (Ibrahimi) i tha babës së vet dhe popullit të tij: “Ç’janë këto idhuj, që ju po i adhuronit kaq shumë?” Ata iu përgjigjën: Kështu kemi gjetur të parët dhe baballarët tanë, i adhuronin këto idhuj. Ibrahimi tha: “Me të vërtetë ju (si) dhe baballarët tuaj jeni në humbje të qartë.” Ata thanë: A na ke sjellë ti të

vërtetën, apo ti je nga ata që tallen? “(Ibrahimi) tha: Jo, por Zoti juaj është Zoti i qiejve dhe i Tokës, që Ai i krijoi ndërsa unë jam njëri prej atyre që e dëshmojnë këtë. Dhe, për Zotin, do t’ju bëjë një dredhi idhujve tuaj, posa të largoheni ju!” Unë i bëra ato copa-copa, përpos idhullit të tyre më të madh, se ndoshta ata do t’i drejtohen atij. (Pasi janë kthyer) Ata thanë:

.....

Enbija 52 - 60

Po ashtu shokët e shpellës a.s. kur janë ballafaquar me mbretin kriminel kanë qenë të rinj, aty prej 16 – 18 vjeç, mirëpo kanë qenë serioz dhe e kanë marr detyrën me përgjegjësi.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Përkujto ti) Kur disa djelmosha u strehuan në shpellë dhe thanë: “O Zoti ynë, dhurona mëshirë nga ana Jote dhe na bëjë të vendosur neve që të jemi në rrugë të drejtë dhe çdo çështje e jona të jetë në drejtësi.” (E pranua lutjet e tyre) dhe në veshët e tyre vendosëm mburojë (i vëmë në gjumë) që të jenë të sigurt në shpellë për shumë vite. Pastaj i kemi zgjuar ata për të vërtetuar secili nga dy grupet të vlerësojë më mirë sa kohë kanë qenë të strehuar. Ne po të tregojmë ty historinë e tyre me tërë vërtetësinë e saj. Ata ishin djelmoshat që besonin në Zotin e tyre, dhe ne ua kemi forcuar rrugën e tyre të drejtë. Dhe Ne, ua forcuam zemrat e tyre, kur u ngritën dhe thanë: “Zoti ynë është Zoti i qiejve dhe i Tokës. Na, nuk iu kemi lutur kurrësi zotit tjetër përpos Tij. Përndryshe – atëherë do të kishim thënë gënjeshtër të madhe.”

El Kehf 10 – 14

Ku është serioziteti ynë me Allahun e Lartmadhëruar?

FORMA TË SERIOZITETIT TË PEJGAMBERIT S.A.V.S., SHOKËVE TË TIJ DHE ATA QË PASUAN RRUGËN E TIJ

Do t’i përmendim disa shembuj të seriozitetit të pejgamberit s.a.v.s., shokëve të tij dhe tabiinëve, Zoti qoftë i kënaqur me ta.

SERIOZITETI I PEJGAMBERIT S.A.V.S.

Pejgamberi s.a.v.s. ka qenë serioz dhe tepër i përpiktë. Gjithmonë ka qenë i përgjegjshëm në kumtimin e fesë dhe përhapjen e saj në tërë botën.

Një ditë shkojnë kurejshitët te Ebi Talibi dhe ankohen për Muhamedin a.s.. Ata kanë paraqitë kërkesë që të ndalohet në thirrje të fesë së tij dhe fyerjen e zotërove të tyre. Në ankimet e tyre thoshin: Djali i vëllait tënd i ka fyer zotat tanë, andaj le të mos vazhdoj thirrje të fesë së tij. Ebu Talibi e pranoi ankesën e tyre dhe shkoi te djali i vëllait, pra te Muhamedi a.s. dhe i thotë: O djalë i vëllait tim. Populli yt ka ardhur tek unë dhe janë ankuar për ty, andaj ke kujdes dhe ndërprite misionin tënd që të bëhet mirë edhe për mua, edhe për ty dhe mos më ngarko me diçka çka nuk mund ta përballoj as unë, dhe mos e ngarko veten me diçka çka nuk mund ta përballosh as ti. Muhamedi a.s. e vërejti se axha i tij Ebu Talibi ishte dorëzuar, ishte dobësuar dhe ishte pesimist, për këtë arsye i thotë: O axha im, edhe sikur diellin të ma jepnin në dorën time të djathtë dhe hënën në dorën time të majtë, kurrë nuk do të largohem nga misioni dhe detyra ime, derisa të mbizotëroj feja e Allahut, ose të vdes duke thirrur ne fenë e Tij.

Ky është serioziteti i vërtetë. Kjo është aftësia për marrjen e përgjegjësisë dhe detyrave.

SERIOZITETI I EBI TALHAS

Enesi r.a. transmeton se kur ndodhi lufta e Uhudit dhe derisa të tjerët janë largua, Ebi Talha qëndronte pranë pejgamberit s.a.v.s. si truproje dhe mburojë e tij, gjoksi i tij qëndronte si pancir i të dërguarit s.a.v.s..

Ebu Talha ka qenë aq i shkathtë sa që shigjetat i kapte në ajër dhe i thyente, kështu që tri shigjeta i kap në ajër dhe i thyen. Kur e panë pabesimtarët, thanë: Gjuani Ebu Talhan. Ebu Talha e shtrinte trupin e tij dhe e mbështetke trupin e tij për Muhamedin a.s., i shikonte gjuetarët pabesimtarë dhe i thonte vetes së tij: Për babë e për nënë o Ebi Talha, mos e kalo kokën, mos e lëkund kokën që të qëllohet i dërguari e të mos qëllohem unë.

Shikoni pra çfarë burrërie, çfarë trimërie, çfarë heroizmi, çfarë serioziteti dhe çfarë shpirti sakrifikues!

SERIOZITETI I EBI BEKRI SIDIKIT, R.A.

Ebu Bekri Sidiki thoshte:

“Për Zotin, asnjëherë nuk kam fjetur, as nuk kam qenë neglizhent, e të harrojë diçka. Unë kurrë nuk dëshiroj të më shpëtojë asgjë pa e kryer, asgjë prej përgjegjësive të mia.”

Ah, çfarë thënie e qëndrueshme, e cila tregon seriozitetin në marrjen e përgjegjësisë.

SERIOZITETI I ENES BIN NADRIT R.A.

Tregon Enesi r.a. se axha i tij, Enes bin Nadr ka munguar në luftën e Bedrit dhe i ka thënë të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.: Kam munguar në luftën e parë të luftës tënde kundër idhujtarëve. Po të mundësonte Allahu të luftoj kundër idhujtarëve një herë tjetër do ta shohin se si do të luftoj. Kur filloi lufta e Uhudit dhe muslimanët kanë dalë në fushëbetejën e Uhudit thotë:

“O Zoti im! Sehabët e Muhamedit a.s. bëjnë luftë mbrojtëse dhe të drejtë, ndërsa idhujtarët luftë agresive dhe të padrejtë. Pastaj, ka dalë i pari në front dhe është takua me Muadh bin Xhebelin dhe i thotë: O Sed bin Muadh: Për xhenetin dhe Zotin tim nën Uhud po e ndiej erën e xhenetit. Tregon Seadi nuk kam mundur të luftoj siç ka luftuar ai. Enesi r.a. tregon se pas betejës e kemi parë si kishte rënë dëshmor dhe në trupin e tij kishte tetëdhjetë shenja të shpatës ose të shigjetës ose të shtizës. E kishin vrarë idhujtarët dhe e kishin masakruar trupin e tij aq shumë sa që askush nuk ka qenë në gjendje ta identifikojë, pos motra dhe vajzat e tij.

Pastaj ka tregua Enesi r.a. se ne kemi menduar se ajeti: “Ka prej besimtarëve burra, të cilët e kanë kryer dhe e kanë vërtetuar premtimin që ia kanë dhënë Allahut.”

(El Ahzab, 22)

Ka zbritur për Enes bin Nadrin dhe burrat e ngjashëm me të.

Sahihul Buhari 2595

SERIOZITETI I EBI EJUB EL ENSARIJUT R.A.

I kishte tetëdhjetë vite, edhe pse ishte plak dhe i pa aftë për luftë thoshte: “Më merrni edhe mua në luftë. I thonin: Aq shumë je plakë sa që edhe vjetullat të kanë rënë poshtë për shkak të pleqërisë. E Ejubi r.a. u thonte: Allahu i Lartmadhëruar ka thënë: “Dilni (në luftë), le t’ju vijë (lufta) e lehtë ose e rëndë, luftoni për hir të All-llahut me pasurinë tuaj dhe me veten tuaj; kjo është gjëja më e dobishme për ju, nëse e kuptoni.”

Et-Tevbe 41

Ky sehabe me renome ka ndërruar jetë nën themelet e Kështjellës së Konstantinopolisit dhe është varrosur aty.

Zoti e mëshiroftë Ejub el Ensariun dhe qoftë i kënaqur me të. Ka qenë shembull tipik i seriozitetit dhe kontributit për islamin dhe përhapjen e tij.

SERIOZITETI I MUHAMED EL FATIHUT R.A.

Që në moshën e rinisë Muhamed el Fatih e ka çliruar Konstantinopolisin, mirëpo ai detyrën e tij e kishte marrë me përgjegjësi dhe me seriozitet.

Dihet se Konstantinopolisi shumë e shumë vite pandërprerë i kishte bërë padrejtësi muslimanëve, mirëpo Muhamed Fatih r.a. e çliroi atë, e merr përgjegjësinë dhe qeverisjen mbi të, gjë që nuk kanë mundur ta marrin atë përgjegjësi edhe heronjtë e mëdhenj, ndërsa ai ishte në moshën më të hershme të rinisë.

Kur e ka marrë pushtetin dhe është emëruar mbret, Muhamed Fatih veç sa i kishte mbushur 20 vite, atëherë kur tek ai janë paraqitur shenjat e gjenialitetit, mençurisë dhe aftësisë në çdo aspekt, posaçërisht në fushën e betejës dhe ushtarake.

Ai kishte vendosur në shënjestër çlirimin e Konstantinopolisit. Qëllim kryesor e kishte atë dhe ishte e pamundur që t’i shpëtoj e të mos e arrij atë qëllim. I ka tubuar forcat, e ka përgatitur ushtrinë, e ka bërë strategjinë luftarake dhe e ka frymëzuar ushtrinë, eprorët në vendosmëri, stoicizëm dhe i ka përgatitur moralisht, psikikisht dhe fizikisht.

Personaliteti, vendosmëria dhe këmbëngulësia kanë qenë faktor mbresëlënës në zemrat e ushtrisë së tij, të cilët dhe e kanë praktikuar vendosmërinë e tij.

Ai gjithmonë i frymëzonte në besim të plotë, lindshmëri të sinqertë, u përkujtonte shpërblimin e Shehidit në rrugën e Allahut të Gjithëfuqishëm, e për këtë arsye ua mundësoi Allahu çlirimin e atyre vendeve.

Ndërsa ju gjenerata e këtij shekulli të Islamit, jeni shpresa dhe aspirata e umetit, shfrytëzoheni kohën tuaj, angazhohuni në bindshmëri të sinqertë ndaj Zotit tuaj, që umeti juaj të ngrihet lartë dhe t’i realizoj qëllimet e tij.

Allahu është me ju, Ai ju përkrah dhe ju ndihmon.

SERIOZITETI I SALAHUDIN EL EJUBIT

Ai thoshte: Si mund të qeshni derisa Mesxhidi Aksaja është e okupuar.
Vërtet, unë turpërohem prej Allahut që të më sheh duke qeshur, ndërsa vëllezërit e mi atje torturohen dhe malltretohen.

Vëllezër!!

Ai ka qenë serioz dhe i përgjegjshëm për atë arsye me dorën e tij Allahu e ka çliruar Mesxhidi Aksanë.

A ka ndonjë të ri prej neve i cili ka seriozitetin e tij?

E lus çdonjërin prej juve, çdo joserioz të marrë për dore dhe të ia tregojë si merret përgjegjësia në këtë fe me të cilën na ka nderuar Allahu, të Cilit i takon përkulshmëria dhe falënderimi.

Umeti patjetër duhet të merr përgjegjësinë me seriozitet para Allahut të Lartmadhëruar.

Çdo pjesëtar i umetit patjetër duhet të merr përgjegjësinë me seriozitet në jetën individuale dhe atë të përgjithshme.

Në fund të fjalimit tim, po ju përsëris tri gjëra:

1. Ta përkujtoni Allahun pandërprerë, dhe të dërgoni salavate për Muhamedin a.s., dhe të bëni lutje për t'iu përlulur vetëm Allahut, për të ngritur umetin dhe për t'i ndihmuar kundër armiqve të tij, posaçërisht në ditën e xhumasë, sepse ajo është dita e kujtimit dhe lutjeve, në të është momenti (çasti) i pranimit të duasë, sipas të gjitha gjasave ai çast është para perëndimit të diellit në atë ditë të bekuar.
2. Në çdo ditë të premte – pra ditën e xhumasë të këndonit suretull Kehf. Këtë na e ka mësuar dhe për këtë na ka këshilluar Muhamedi a.s., ndërsa nuk ka këshillë më të mirë se këshilla e Muhamedit s.a.v.s..
3. Të përsëriturit e Imamëve të xhamive për lutje që të tejkalohen fatkeqësitë e umetit dhe t'iu ndihmuar atyre kundër armiqve të tyre, dhe atë ta bëjnë brenda namazeve, dhe në minbere.

Në fund:

Shpresoj që Allahu t'ia mundësoj që kush e lexon këtë porosi t'i bëjë dobi, që Allahu t'na e shkruaj prej veprave të mira, ta vendos në peshoren e të mirave, dhe t'na i shlyej veprat e këqija.

Shpresoj se Allahu do t'mi falë gabimet dhe çështjet që i kam harruar.

Dëshmoj para Allahut dhe para gjithë krijesave të tij, se çka e kam qëlluar dhe është e drejtë, është prej asaj çka më ka mësuar Allahu xh.sh., dhe çka kam përfituar prej të Dërguarve të Tij, s.a.v.s., ndërsa çka kam harruar dhe kam gabuar është prej vetes sime dhe prej shejtanit të mallkuar.

Allahu xh.sh. dhe i Dërguari i Tij janë të pastër nga ajo.

Lus Allahun për falje, që t'më kursej prej mëkateve dhe lajthitjeve, prej të metave dhe zbrastirave mua, dhe lexuesve.

Po ashtu lus Allahun që këtë fjalim ta bëjë rrugë në drejtim të seriozitetit, vendosmërisë dhe marrje të përgjegjësisë të personave dhe të rinjve të umetit, të burrave dhe të tjerëve në përgjithësi.